

Mesazh i Ministrit të Brendshëm

Në katër vitet e shkuara, ne ia dolëm të përmirësonim rrënjësisht situatën e rendit dhe të sigurisë publike në vend, kjo si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e reformave të thella ligjore dhe institucionale që qeveria ndërmoi. Jeta dhe prona e qytetarëve sot është më e sigurtë se më parë. Shqipëria, sot, është një vend më i sigurt për investitorët dhe këdo të huaj tjetër që për arsye të ndryshme e viziton këtë vend.

Mandati i fituar në zgjedhjet e qershorit 2017, në radhë të parë si shprehje e njohjes nga ana e qytetarëve të rezultateve të arrira në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, e detyron shumicën qeverisëse të sotme të marrë përgjegjësi, ushtrimi i të cilave e çon standardin e rendit dhe të sigurisë në atë të nivelit më të lartë europian.

Ky Dokument prezanton qëllimet dhe objektivat në ushtrim të kësaj përgjegjësie, si dhe kohën, mjetet, mënyrat për përmbushjen e saj. Lufta, në radhë të parë, për parandalimin e krimit, por edhe goditja kundër tij, qenia gjithmonë e strukturave përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike në mbrojtje të lirive dhe të drejtave themelore të qytetarëve përbëjnë prioritetet e kësaj qeverie.

Ai është produkt i një analize të kujdesshme të arritjeve të deritanishme, të problemeve dhe të sfidave që kemi përpara, të cilat jemi të vendosur t'i fitojmë. Ky dokument ndjek standardet më të mira ndërkombëtare dhe është rezultat i një bashkëpunimi të frytshëm me agjencitë ligj zbatuese, profesionistë të së drejtës, shoqërinë civile dhe publikun.

Ky Dokument është konsultuar gjithashtu, me organizatat partnere ndërkombëtare, si dhe përfaqësues të vendeve të BE, në Tiranë. Gjej rastin të falënderoj të gjithë dhe secilin prej tyre për kontributet me vlerë që kanë dhënë, duke bërë të mundur që ky Dokument të paraqitet në përmbajtjen dhe formën që ka sot.

Përmbushja me sukses e prioriteteve të paraqitura në këtë Dokument, është me rëndësi të jashtëzakonshme në rrugën e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian. Të gjithë së bashku kemi një dhe vetëm një sfidë : të fitojmë betejën për një Shqipëri më të mirë dhe më të sigurt. Ky është detyrim ndaj qytetarëve, ndaj të ardhmes së vendit dhe fëmijëve tanë.

Si Ministër i Brendshëm, inkurajoj dhe mbështes fuqimisht të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit në punën e tyre fisnike në shërbim të qytetarëve dhe në përballimin e sfidave të së ardhmes. Jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi marrë, i vendosur dhe i angazhuar që, së bashku me ju dhe me ekipin që do të drejtoj, të hapim një faqe të re në këtë fushë, duke iu përgjigjur kësaj pritshmërie të larta të publikut dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë që na mbështesin.

Ju faleminderit të gjithëve!

Sinqerisht,

Fatmir Xhafaj



POLITIKAT PRIORITARE NË FUSHËN E RENDIT DHE SIGURISË

“Në shërbim të qytetarëve, në zbatim të ligjit”

QËLLIMI

Në zbatim të programit politik të Këshillit të Ministrave, të funksioneve dhe kompetencave të Ministrisë së Brendshme, ky dokument synon të përcaktojë prioritetet, objektivat dhe masat kryesore, në përpjekjen për arritjen e standardeve të shtetit të së drejtës në fushën e sigurisë dhe rendit publik, në parandalimin dhe luftën ndaj krimit, në shërbim të të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

ARRITJE, PROBLEME DHE SFIDA

Arritjet

Situata e sigurisë dhe e rendit publik në vend është përmirësuar rrënjësisht në katër vitet e fundit. Shqipëria është sot një vend më i sigurt për të gjithë ata që jetojnë në territorin e saj, për jetët, bizneset dhe pronat e tyre, për investimet e huaja dhe turistët që e vizitojnë atë.

Kjo arritje ka në gjenezë, reforma të thella normative dhe organizative konkrete si përmirësimi i kuadrit ligjor të veprimtarisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera ligjëzbatuese në varësi të saj, miratimi i ndryshimeve dhe shtesave në ligjin antimafia,¹ Kodin e Procedurës

1 Ligji nr 24/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr 10192, datë 3/12/2009 "Për Parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit përmes masave parandaluese kundër pasurisë"

Penale² dhe legjislacionin mbi përgjimet³ dhe mbikëqyrjen.

Në kuadër të luftës ndaj lëndëve narkotike, aprovimi i instrumenteve programatike si “Plani i veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit për periudhën 2017 – 2020” dhe kurorëzimi me sukses i operacioneve policore kundër kultivimit të kanabisit në Lazarat⁴, Dukagjin dhe disa zona të tjera problematike, kanë prodhuar rezultate pozitive jo vetëm sa i takon sasisë së asgjësuar e sekuestruar,⁵ por edhe në rikthimin e ligjshmërisë dhe kontrollit të shtetit në këto zona.⁶

Reformimi i strukturave dhe funksionimit të Policisë së Shtetit, fokusuar në reformën e personelit, rritjen e bashkëpunimit operacional, shkëmbimin e shpejtë të informacionit policor, mbështetjes logjistike dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit të publikut si dhe përmirësimet në drejtim të transparencës, lehtësimit të procedurave, dixhitalizimit të shërbimeve të policisë, shërbimin ndaj qytetarit, si dhe trajtimin financiar, ekonomik dhe logjistik janë të arritje të dukshme dhe të prekshme.

Ringritja e Akademisë së Sigurisë do t’i shërbejë formimit të një force policore profesionale të mirë arsimuar dhe trajnuar.⁷

Përmirësimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar, sidomos me Europol në luftën kundër krimit të organizuar⁸ dhe terrorizmit, ka

2 Ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i procedurës penale i republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”

3 N.Ligj nr. 69/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9157, datë 4.12.2003, “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, të ndryshuar

4 Një total prej 551414 rrënjë kanabis u shkatërruan atë vit, e cila përbënte një rritje me 460% krahasuar me vitin 2013

5 Referuar të dhënave të përcjella Policisë së Shtetit nga specialistët e Interforza, për rezultatet e monitorimeve nga ajri në vitin 2013 të komunës Lazarat, Gjirokastrë.

6 Komisioni European, ‘Raporti mbi Shqipërinë 2015’, f. 65, i aksesueshëm online në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_albania.pdf

7 Komisioni European, ‘Raporti mbi Shqipërinë 2016’, f. 73, i aksesueshëm online në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

8 Komisioni European, ‘Raporti mbi Shqipërinë 2016’, f. 19, i aksesueshëm online në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

sjellë reduktimin e numrit të shtetasve shqiptarë, të rekrutuar si luftëtarë terroristë të huaj.⁹

Të gjitha këto, kanë ndikuar në rritjen e besimit publik ndaj Policisë së Shtetit si institucioni më i besuar nga publiku, sipas një hulumtimi të realizuar në nivel kombëtar.¹⁰

Problemet

Pavarësisht arritjeve të këtyre katër viteve, jemi të ndërgjegjshëm se ka ende një sërë çështjesh, të cilat kërkojnë vëmendjen e duhur të institucioneve ligj-zbatuese.

Policia e Shtetit përballet çdo ditë me sfidat që kanë të bëjnë me presionin politik dhe ekonomik, lidhjet politike apo edhe kriminale të disa prej drejtuesve apo punonjësve të saj, infrastrukturë të dobët dhe mungesë pajisjesh apo mbikëqyrje të pamjaftueshme,¹¹ duke vështirësuar kështu ushtrimin e detyrës sipas standardeve të kërkuara dhe zbatimin korrekt dhe të paanshëm të ligjit¹².

Përfshirja e disa punonjësve të policisë në korrupsion ka ndikuar në pengimin e hetimeve të thelluara ndaj krimit të organizuar.¹³

9 Europol, 'Raporti mbi Situatën dhe Prirjet e Terrorizmit në Bashkimin Europian', 2017, f. 33., i aksesueshëm online në: <https://www.europol.europa.eu/activities-services/main-reports/eu-terrorism-situation-and-trend-report-te-sat-2017>

10 IDRA, 'Pandëshkueshmëria: Opinioni publik mbi kuptimin, arsyet dhe rolin e institucioneve', 2017, i aksesueshëm online në: http://www.idrainstitute.org/files/impunity_final_report_2017.pdf

11 Departamenti Amerikan i Shtetit, 'Raporti për të Drejtat e Njeriut, Shqipëri 2016', <https://www.state.gov/documents/organization/265600.pdf>

12 IDRA, 'Pandëshkueshmëria: Opinioni publik mbi kuptimin, arsyet dhe rolin e institucioneve', 2017, i aksesueshëm online në: http://www.idrainstitute.org/files/impunity_final_report_2017.pdf

13 Komisioni Europian, 'Raporti mbi Shqipërinë 2016', f. 73, i aksesueshëm online në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

Ai mbetet problem serioz,¹⁴ lufta ndaj të cilit në të gjitha nivelet¹⁵ është një nga prioritetet thelbësore për vendin. Me gjithë rritjen e numrit të të ndëshkuarve, shumica e tyre i përkasin punonjësve të policisë së niveleve të ulëta dhe të mesme.

Të tjera çështje që duhet të konsiderohen akoma probleme mbeten gjithashtu pastrimi i parave, informaliteti, tregu i zi i mallrave, si dhe veprimtaritë kryesore kriminale si: trafikimi i drogave, evazioni fiskal, kontrabanda dhe trafikimi i qenieve njerëzore.¹⁶ Ndonëse kapacitetet e policisë në këtë drejtim janë forcuar, kërkohet më tepër staf dhe hetime të specializuara.

Bashkëpunimi ndërkombëtar i Policisë së Shtetit, sidomos me Europol dhe Interpol, duhet përmirësuar në mënyrë që të jetë më shumë proaktiv, ndërsa bashkëpunimi ndërinstitucional, sidomos me Prokurorinë, në drejtim të zbulimit dhe hetimit të çështjeve kriminale komplekse konsiderohet i dobët. Nevojitet një qasje gjithëpërfshirëse në hetime dhe ndjekje penale, akses i drejtpërdrejtë në disa databaza publike dhe private¹⁷, si dhe përmirësim në marrjen e informacionit në raportet dërinstitucionale.¹⁸

Kapacitetet e stafit që përballet me krizën migratore kanë nevojë të forcohen në drejtim të identifikimit të migrantëve të kontrabanduar dhe personave të trafikuar. Zbulimi i dokumenteve false ka mbetur në nivele të ulëta, sidomos në aeroportin ndërkombëtar.¹⁹

14 Komisioni Europian, 'Raporti mbi Shqipërinë 2016', f. 4, i aksesueshëm online në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

15 Po aty.

16 Departamenti Amerikan i Shtetit, "International Narcotics Control Strategy Report Volume II: Money Laundering and Financial Crimes –Albania", pf.2, Mars 2017, i aksesueshëm online në: <https://www.state.gov/documents/organization/268024.pdf>

17 Konstatime nga minutat e takimit me Prokurorët për hartimin e këtij dokumenti politikash, datë 27.07.2017

18 Policia e Shtetit, 'Vlerësimi i Kërcënimit të Krimin të Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda – SOCTA 2016', f.20.

19 Komisioni Europian, 'Raporti mbi Shqipërinë 2016', f. 72, i aksesueshëm online në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

Sfidat

Me qëllim parandalimin dhe luftën ndaj krimit, rritjen e profesionalizmit dhe integritetit të institucioneve të sigurisë dhe rendit publik, përmirësimin e mëtejshëm të besimit të publikut tek këto institucione, përpjekjet për katër vitet e ardhshme do të fokusohen në katër drejtime kryesore.

Së pari, policia e Shtetit do të duhet të reformohet përmes kryerjes së një procesi pastrimi (vetingu) nëpërmjet mekanizmave verifikues dhe kontrollues të figurës, pasurisë dhe aftësive profesionale. Kjo përpjekje duhet të shoqërohet me përmirësim të cilësisë së edukimit/trajnimit fillestar dhe atij të vazhdueshëm të punonjësve të policisë së shtetit, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve akademike të Akademisë së Sigurisë²⁰, qoftë në drejtim të rritjes së profesionalizmit të trupës së saj akademike qoftë nëpërmjet përmirësimit të programeve dhe kurrikulave të saj. Trupës policore duhet t'i garantohet një proces emërimi dhe vlerësimi transparent dhe një procesi promovimi bazuar në meritë. Duhet adoptuar gjithashtu politika dhe procedura për eliminimin e lidhjeve politike apo nepotike në strukturat e saj, si dhe duhet hartuar politikave motivuese dhe nxitëse për të gjithë punonjësit me qëllim rritjen e dinjitetit të tyre dhe besimit të publikut.

Së dyti, duhet forcuar lufta ndaj krimit të organizuar dhe trafiqeve me prioritet intensifikimin e përpjekjeve ndaj grupeve kriminale dhe luftën ndaj trafikut të lëndëve narkotike. Ky rezultat është gjithashtu i arritshëm nëse ka një qasje proaktive në hetimin, zbulimin dhe goditjen e trafikimit të drogave të forta, nëpërmjet bashkëpunimit më të ngushtë ndër-institucional, rajonal dhe ndërkombëtar. Drejtuesit e grupeve të strukturuar dhe organizatave kriminale, si dhe pasuritë e tyre, duhet t'i nënshtrohen një hetimi profesional dhe proaktiv. Kjo realizohet duke forcuar bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë, sa i takon hetimit dhe arrestimit të autorëve shqiptarë të veprave penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

20 Rekomandime nga Takimi me pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë, datë 27.07.2017

Së treti, një sfidë jo pak e rëndësishme është edhe lufta ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm përmes hetimeve proaktive, vlerësimeve sistematike të riskut dhe bashkëpunimit më të mirë ndërinstytucional, monitorimit të flukseve migratore me qëllim eliminimin e mundësisë së përdorjes së tyre për maskimin e pjesëtarëve të organizatave terroriste midis refugjatëve²¹, intensifikimit të përpjekjeve për parandalimin e radikalizmit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, policimit në komunitet dhe bashkëpunimit të ngushtë me komunitetet fetare dhe shoqërinë civile, dhe kryerjes së hetimeve të detajuara të tentativave për financimin e terrorizmit nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional me organet që monitorojnë flukset e qarkullimit të mjeteve financiare.

Së katërti, siguria dhe rendi publik mund të përmirësohen nëpërmjet parandalimit të veprave penale dhe krimeve të tjera, duke u udhëhequr nga filozofia e “policimit në komunitet”, përmes ndërveprimit të vazhdueshëm me komunitetin dhe organet e qeverisjes vendore; sigurimit të ligjshmërisë në territor dhe një marrëdhënie e re me biznesin në funksion të garantimit të sigurisë së qytetarëve; përmirësimit të menaxhimit të qarkullimit rrugor me synim minimizimin e aksidenteve; vazhdimin të projekteve të rëndësishme si ai i dorëzimit vullnetar të armëve, apo parandalimit dhe përbalimit të situatave emergjente; ridimensionimit të rolit të Prefektit për menaxhimin dhe koordinimin e kontrollit në territor dhe forcimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile në nivel kombëtar dhe vendor.

²¹ Policia e Shtetit, ‘Vlerësimi i Kërcënimit të Krimit të Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda – SOCTA 2016’, f. 76.

I. Institucione të forta, profesionistë me integritet

Angazhimi ynë është të japim një kontribut aktiv në konsolidimin e një shteti më të sigurt, në të cilin mbizotëron respektimi i të drejtave të individëve të garantuara nga Kushtetuta dhe ligjet, në krijimin e institucioneve ligj-zbatuese të forta dhe të qëndrueshme, sipas standardeve evropiane.

Objektivat e këtij prioriteti përfshijnë:

1. Forcimin e kapaciteteve institucionale dhe garantimin e pavarësisë operacionale të policisë së shtetit dhe strukturave të kontrollit të brendshëm;
2. Funksionimin e institucioneve dhe strukturave në varësi me profesionistë me integritet moral dhe karakter të fortë njerëzor;
3. Konsolidimin e arsimit, kualifikimit dhe veçanërisht trajnimit të vazhdueshëm e të profilizuar të strukturave të Policisë së Shtetit;
4. Garantimin e një sistemi karriere, promovimi dhe vlerësimi objektiv të qëndrueshëm dhe të bazuar në meritë;
5. Hapjen dhe demokratizimin e mëtejshëm të institucioneve dhe strukturave në varësi përmes transparencës, informimit të publikut, llogaridhënies dhe një komunikimi më aktiv me organizatat e shoqërisë civile, medias dhe gazetarisë investigative;
6. Forcimin e kapaciteteve planifikuese, mbikëqyrëse dhe kontrolluese të Ministrisë, për zbatimin e politikave dhe objektivave;
7. Rritja e performancës, forcimi dhe fuqizimi i mirëqeverisjes dhe demokracisë vendore.

Në funksion të përmbushjes së këtij prioriteti strategjik dhe objektivave përkatës do të ndërmerren masat e mëposhtme :

- Analizimi dhe rikonceptimi i sistemit të rekrutimit, qëndrimit në detyrë dhe promovimit, bazuar në meritë, dhe trajnimit të vazhdueshëm profesional;
- Garantimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor, zhvillimit të testeve objektive sipas funksionit dhe gradave, duke parandaluar ndikimin politik, sjelljen jo profesionale dhe jo etike, lidhjet me krimin dhe korrupsionin. Ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm identifikimi dhe ndëshkimi ndaj rasteve të tilla;
- Rishikimi i strukturës së personelit me qëllim rritjen e efikasitetit, performancës dhe etikës në punë;
- Përdorimi i procedurave standarde të matjes së performancës (projekti SACP);
- Ndryshimi i Ligjit “Për Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave”, me qëllim zgjerimin e fushës së zbatimit dhe hartimi i aktit për konfigurimin e rubrikës “Menaxhimi i Çështjes”;
- Përfundimi i dixhitalizimit të dokumentacionit të administruar në kartotekën dhe sekretarinë e SHÇBA-së;
- Realizimi i një procesi të kontrollit të figurës, pasurisë dhe profesionalizmit (i njohur ndryshe si “vetting”), të cilit do t’i nënshtrohen punonjësit e Policisë së Shtetit dhe jo vetëm, nga nivelet më të larta drejtuese deri tek efektivi i rolit bazë, të monitoruar nga partnerët ndërkombëtarë;
- Përcaktimi i kuotave konkrete për më shumë punonjëse gra dhe vajza në radhët e policisë së shtetit dhe promovimi i tyre në funksione menaxheriale dhe drejtuese;
- Rishikimi i Rregullores së Brendshme dhe Kodit Etik të institucionit;

- Ngritja e sistemit kombëtar të monitorimit të performancës në nivel vendor;
- Shfrytëzimi i ekspertizës së posaçme përmes ndjekjes së politikave tërheqëse të punësimit, marrëdhënieve me shoqatat profesionale dhe programeve të stazhit;
- Riorganizimi i strukturave policore qendrore dhe vendore me asistencën e partnerëve ndërkombëtarë, për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore, kapaciteteve operacionale, financiare dhe infrastrukture;
- Realizimi i një analize mbi gjendjen aktuale të burimeve njerëzore, infrastrukturës, logjistikës, pajisjeve e programeve teknologjike, të shoqëruar me një masterplan të zhvillimit të tyre përmes buxhetit të shtetit dhe donacioneve të huaja;
- Hartimi i një kuadri ligjor për menaxhimin më efektiv dhe me transparencë të procesit të prokurimeve të përqendruara në MPB;
- Ristrukturimi i institucionit të Ministrisë së Brendshme në funksion të jetësimit të prioriteteve dhe objektivave të këtij dokumenti;
- Rikonceptimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Antitrafikut dhe Azilit në Ministrinë e Brendshme në drejtim të mbulimit të tri fushave: anti-trafikimi, azili dhe migrimi;
- Ristrukturimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Integritit në Ministrinë e Brendshme në funksion të rritjes së kapaciteteve politikbërëse, planifikuese, mbikëqyrëse dhe koordinuese;
- Ngritja e një Sektori për Hulumtimin, Analizën dhe Statistikat në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Integritit;
- Hartimi i një plani komunikimi me publikun, organizimi i

strukturave përkatëse që sigurojnë transparencë të plotë dhe parandalojnë keqinformimin.

- Akreditimi i Akademisë së Sigurisë;
- Përcaktimi i kriterëve më të larta të pranimit në Akademinë e Sigurisë, rritja e cilësisë së programeve dhe kurrikulave mësimore, nivelit profesional dhe etik të mësimdhënies dhe trajnimit, modernizimin e infrastrukturës mësimore, binjakëzimin me institucionet homologe përëndimore;
- Funkcionimi i Akademisë së Sigurisë si qendra e vetme e formimit profesional, trajnimit dhe kualifikimit të të gjithë punonjësve të policisë, strukturave të policisë gjyqësore pjesë e ekzekutivit dhe shërbimeve të tjera të sigurisë;
- Programimi i trajnimeve të specializuara brenda vendit në bashkëpunim me Kolegjin e Policisë Europiane – CEPOL, si dhe pjesëmarrja në programe ndërkombëtare trajnimi;
- Zbatimi i një sistemi karriere me tri trajektore (“three-track system”) duke lehtësuar hyrjen e të diplomuarve nga shkencat juridike, sociale, ekonomike dhe IT.
- Zhvillimi i trajnimeve të posaçme për nivelin menaxherial në Polici dhe shtimin e aftësive gjuhësore në kriteret e pozicionit të punës.
- Profilizimin e trajnimit në përputhje me detyrat funksionale të punonjësve të Policisë së Shtetit.
- Ngritja e Forumit Këshillimor pranë Ministrisë së Brendshme, i përbërë nga përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, pedagogë të së drejtës penale dhe kriminologjisë, gazetarë, ekspertë dhe studiues të pavarur në fushat e shtetit të së drejtës, rendit publik dhe sigurisë;
- Hartimi i një Plani Masash në mbështetje të fëmijëve të policëve të rënë në krye të detyrës;

- Përmirësimi i kujdesit shëndetësor dhe sigurimi i kujdesit psiko-social të punonjësve të policisë;
- Ndërtimi i një sistemi të veçantë për vlerësimin përmes stimuljeve moral dhe shpërblimit material për kontributin në vite të punonjësve, si dhe atyre me rezultate të larta në kryerjen e detyrës;
- Vënia në funksionim e Këshillit Konsultativ “Qeveri-Vetëqeverisje Vendore”;
- Ridimensionim i rolit të prefektit në raport me sistemin e ri të mbrojtjes civile;
- Ngritja e rrjetit të koordinatorëve të BE-së në bashki;
- Përmbyllja e procesit të transferimit të kompetencave dhe asetëve për funksionet e decentralizuara rishtazi;
- Përmirësimi i legjislacionit dhe zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Decentralizimit dhe Vetëqeverisjes Vendore 2015-2020.

II. Institucione në shërbim të qytetarit. Parandalimi - synim në luftën kundër krimit

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimi i sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, janë prioritet absolut për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si togfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, ‘kontrollin e territorit’ dhe ‘policimin në komunitet’. Këto të realizuara në praktikë edhe përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor, në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit.

Jemi të orientuar qartë nga motoja “Në shërbim të qytetarëve, në zbatim të ligjit”, ndaj dhe i gjithë ky sistem do të ristrukturohet për

t'u decentralizuar në funksion të një pranie më efektive në territor dhe për një lidhje më organike me komunitetin dhe strukturat përfaqësuese të tij. Kusht ky për të nxitur "proaktivitetin", "ndërveprimin e vazhdueshëm me komunitetin" si garanci për parandalimin e ngjarjeve që shqetësojnë publikun, zgjidhjen e konflikteve, si dhe zbulimin e autorëve të veprave penale, por edhe për të forcuar besimin e publikut ndaj policisë, sjelljen etike dhe profesionale të drejtuesve dhe specialistëve të policisë së zonës, si dhe perceptimet e qytetarëve për nivelin e sigurisë në komunitetin e tyre. Ky sistem do të ketë si tregues kryesor të suksesit parandalimin në trajtimin e veprave penale të lehta dhe sjelljeve antishoqërore, të cilat nëse neglizhohen mund të përcjellin mesazhin se askush nuk shqetësohet për zgjidhjen e tyre, duke lejuar shpeshimin e tyre, shfaqjen e veprave penale më të rënda dhe rrjedhimisht degradimin urban dhe rritjen e frikës ndaj krimit në komunitet.

Objektivat e këtij prioriteti përfshijnë:

1. Ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme ndërveprimi dhe besimi ndërmjet komunitetit dhe policisë. Nxitjen e pjesëmarrjes aktive të komunitetit dhe përfaqësuesve të tij në çështjet e parandalimit dhe reagimit ndaj shkeljeve të ligjit në territor, duke synuar një rol shumë më aktiv të qytetarëve në sinjalizimin, identifikimin, zbulimin dhe ndëshkimin shoqëror të shkelësve të ligjit;
2. Koordinimin dhe bashkëpunimin më të mirë për çështje të parandalimit të luftës kundër kriminalitetit, ndërmjet strukturave të policimit në komunitet dhe atyre të qeverisjes vendore, organeve ligj zbatuese, organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve fetare në një territor të caktuar, duke përfshirë forcat e ndryshme politike;
3. Ndryshimin cilësisht të sistemit të kontrollit të territorit dhe policimit në komunitet në funksion të parandalimit të kriminalitetit dhe shkeljeve të ligjit, duke synuar uljen në

mënyrë të ndjeshme të numrit të personave të përfshirë në vepra penale të lehta dhe shkelje të ligjeve dhe sidomos për uljen e numrit të të miturve dhe të rinjve të përfshirë në krime;

4. Rritjen e forcës parandaluese dhe ndëshkuese ndaj rasteve të dhunës në familje dhe në komunitet, gjakmarrjes dhe nxitjes së radikalizmit;
5. Forcimin e kujdesit, mbështetjes dhe mbrojtjes ndaj shtresave në nevojë të shoqërisë, duke përfshirë gratë, të miturit, viktimat e trafikimit dhe dhunës, si dhe të ngjuarit për shkak të gjakmarrjes;
6. Rritjen e vëmendjes për parandalimin dhe trajtimin e veprave penale të lehta dhe sjelljeve antishoqërore. Parandalimin dhe reagimin efikas ndaj rasteve të dhunës në familje dhe abuzimeve me të miturit, duke synuar që të dëmtuarve t'u sigurohet një trajtim i kujdesshëm dhe referim për asistencë në institucionet përkatëse.

Në funksion të përmbushjes së këtij prioriteti strategjik dhe objektivave përkatës do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Hartimi i një Strategjie gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale për Sigurinë në Komunitet, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë;
- Nënshkrimi i “Memorandumeve Shoqërore për Siguri” dhe ngritja dhe funksionimi i “Këshillave Rajonalë të Sigurisë”, të cilat nën drejtimin e prefektit të qarkut do të përfshijnë përfaqësues të policisë, prokurorisë, gjykatës, prefekturës, bashkisë, organizatave jo qeveritare, medias lokale dhe qytetarëve;
- Riorganizimi i strukturave vendore të policisë, mbështetur mbi një analizë rreth dinamikave të kriminalitetit, sipërfaqes së territorit dhe numrit të popullsisë. Rivlerësimi i rolit të punonjësve të policisë në komunitet, përcaktimi i detyrave

funkionale dhe përgjegjëse për mbikëqyrjen e territorit dhe veprimtarive në komunitet. Rishikimi i kriterëve të përzgjedhjes, si dhe vlerësim e promovim i këtyre punonjësve në përputhje me performancën edhe shkallën e perceptimit të qytetarëve, në raport me sigurinë dhe sjelljen etike të tyre në komunitet.

- Hapja e zyrave të sigurisë në komunitet, “Policia në shërbimin tuaj” në funksion të sigurimit të mjediseve të përshtatshme të punës për punonjësit e policisë, për pritjen e qytetarëve të zonës dhe mbajtjen e databazave me të dhënat policore përkatëse, si dhe kryerjen e veprimeve administrative e policore të nevojshme;
- Hapja dhe funksionimi në Ministrinë e Brendshme të një ambienti të posaçëm për ofrimin në një sportel, të një sërë shërbimesh për qytetarët, për regjistrimin e ankesave dhe informimin publik;
- Realizimi i anketimeve dhe shqyrtimi i ankesave të qytetarëve ndaj shërbimeve të ofruara dhe performancës së punonjësve të ministrisë, policisë dhe institucioneve të tjera në varësi të shprehura në sportele, on-line, përmes linjave të gjelbra apo postës;
- Vendosja e kontakteve të drejtpërdrejta të punonjësit të policisë me komunitetin përmes patrullimeve në këmbë, takimeve derë më derë, patrullimeve të përbashkëta me qytetarët pranë zonave më të frekuentuara dhe problematike;
- Organizimi i takimeve të hapura në komunitet, në funksion të rritjes së eficientë, transparencës dhe monitorimit më të mirë të policimit në komunitet;
- Fuqizimi i shërbimit të psikologut/sociologut në strukturat e Policisë së Shtetit;
- Intensifikimi i programeve të edukimit publik në shkolla përmes një bashkëpunimi shumë më efektiv me institucionet e arsimit dhe organizatat e shoqërisë civile;

- Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese në lidhje me rëndësinë e masave parandaluese, kyesisht në drejtim të radikalizmit dhe përfshirjes në kriminalitet apo krim të organizuar sidomos të të miturve dhe të rinjve;
- Forcimi i monitorimit të punës së punonjësve të policisë për identifikimin dhe raportimin e krimeve të lehta të ndodhura në territor;
- Kontrolli i efektshmërisë dhe transparencës së trajtimit të rasteve të raportuara përmes Komisarariatit Dixhital;
- Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të urdhrave të mbrojtjes.
- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për parandalimin e dhunës në familje në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe partnerët.
- Përfundimi i projekteve të nisura, duke përfshirë atë të popullimit apo sistemit të adresave, zbatimin e projektit për vendosjen e sinjalistikës në territor, dixhitalizimin e arkivave dhe përmirësimi i shërbimit në sportelet e zyrave të gjendjes civile nëpërmjet ngritjes së infrastrukturës IT dhe aplikimit të sistemit elektronik, etj;
- Zbatimi i sistemeve të avancuara teknologjike të mbikëqyrjes së territorit, kryesisht të zonave të “nxehta” të krimit (hot-spots), me qëllim evidentimin e saktë të tyre dhe përqendrimin më të mirë në to të burimeve policore.

III. Lufta kundër krimit të organizuar – sfidë madhore

Lufta pa kompromis dhe ndëshkimi i ashpër penal ndaj grupeve dhe/ose organizatave kriminale të ndryshme, si dhe i grupeve me axhenda ekstremiste të dhunshme dhe terroriste duke shënjestruar, sekuestruar dhe konfiskuar çdo aset ekonomik të paligjshëm të tyre përbën një prioritet absolut për qeverinë shqiptare.

Shqipëria nuk mund të jetë një “parajsë” apo “strehë e sigurt” e trafikantëve të qenieve njerëzore, drogës dhe armëve, të cilët kanë vepruar brenda apo jashtë vendit dhe kanë përfituar deri më tani kryesisht për shkak të problemeve të theksuara të sistemit të drejtësisë së korruptuar që kemi pasur. Kjo qeveri ka vullnetin e palëkundur për të ndryshuar rrënjësisht situatën në këtë drejtim. **Shënjestrimi dhe goditja e veprimtarive të krimit të organizuar dhe rrjeteve kriminale, përbën prioritet madhor të qeverisë shqiptare.**

Objektivat e këtij prioriteti përfshijnë:

1. Aplikimin e një qasje të re dinamike dhe fleksibël, e cila do të synojë krijimin e një ambienti dekurajues për këdo që përfshihet në krim të organizuar, goditjen e tyre në një mënyrë të kryqëzuar (disruptive approach), përmes koordinimit më të mirë të veprimtarive dhe masave të agjencive të ndryshme ligj zbatuese në këtë drejtim;
2. Riorganizimi i shërbimit të policisë gjyqësore në radhët e policisë së shtetit në nivel qendror dhe vendor, përcaktimin e funksioneve, përgjegjësive dhe pikave të koordinimit e bashkëveprimit. Forcimin e kontrollit dhe llogaridhënies, përcaktimin e kriterëve dhe rregullave të rekrutimit, promovimit dhe vlerësimit në detyrë, si dhe vlerësimit mbi bazë rezultatesh konkrete e objektive dhe jo në bazë të statistikave formale;
3. Riorganizimi i strukturave të hetimit në Policinë e Shtetit, duke forcuar përgjegjësinë dhe kontrollin e tyre vertikal, cilësinë e oficerëve dhe agentëve. Mbështetjen e tyre me teknologji bashkëkohore, përdorimin më efektiv të burimeve njerëzore dhe logjistike, me synim kryerjen e hetimeve proaktive dhe cilësore;
4. Intensifikimin e shkëmbimit të informacionit, kryerjes së hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta me agjencitë e huaja homologe ndaj shtetasve shqiptarë të përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar jashtë vendit;

5. Rritjen e numrit të veprimtarive dhe takimeve të përbashkëta me prokurorinë në veçanti, por edhe agjencitë e tjera ligj zbatuese, si dhe përmirësimin e procedurave për marrjen dhe ndarjen e informacionit dhe përdorimin e mjeteve speciale të hetimit;
6. Ruajtjen në nivelin “I ULËT” dhe marrjen e masave të nevojshme për parandalimin e akteve terroriste, në bashkëpunim me shërbimet inteligjente dhe ligj zbatuese në vend dhe rajon.

Në funksion të përmbushjes së këtij prioriteti strategjik dhe objektivave përkatës do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Rikonceptimi i Departamentit për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, me asistencën e partnerëve ndërkombëtarë, i orientuar drejt një strukture autonome dhe hierarkike brenda Policisë së Shtetit për gjurmimin, zbulimin dhe hetimin e veprimtarisë kriminale në këtë fushë. Krijimi i drejtorive rajonale, duke ridimensionuar mënyrën e bashkëpunimit e ndërveprimit me BKH, SPAK dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore;
- Zbatimi për herë të parë i “goditjes nga shumë fronte” i personave të përfshirë në krim të organizuar, bashkërendimin dhe përdorimin e një sërë taktikash dhe kompetencash të strukturave të Policisë (rendit, rrugore, kufirit dhe migracionit, etj.) dhe agjencive partnere (FIU, organet tatimore, etj), krahas operacioneve të orientuara ngushtësisht drejt veprimtarive të caktuara të krimit të organizuar;
- Hartimi i Planit të Veprimit të Luftës kundër Trafikimit të Personave 2018-2020;
- Rishikimi i udhëzimit për përcaktimin e procedurave standarde për raportimin, monitorimin dhe mbajtjen e statistikave, mbi të cilat do të bëhet vlerësimi i realizimit të objektivave të Policisë së Shtetit, në fushën e luftës kundër krimit të organizuar;

- Hartimi i kuadrit ligjor të nevojshëm për sigurimin e aksesit të strukturave të Policisë së Shtetit në databazat e operatorëve publik të telekomunikacionit;
- Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike për zbatimin e instrumenteve ligjore për realizimin e përgjimeve;
- Transpozimi i Konventës së Vjenës “Për Bashkëpunimin Policor në Evropën Juglindore” në legjislacionin e brendshëm procedural penal;
- Modernizimi i plotë dhe përditësimi i sistemit MEMEX, duke synuar ngritjen e një historiku solid të dhënash të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në të gjitha fushat;
- Organizimi i Forcave të Posaçme Operacionale sipas strukturës së Departamentit të Krimit të Organizuar;
- Ngritja dhe funksionimi i një strukture të posaçme në Departamentin për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, për ndjekjen dhe fillimin e proceseve penale ndaj shtetasve shqiptarë të përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar jashtë vendit, duke përfshirë trafikimin dhe shitjen e narkotikëve, trafikimin dhe shfrytëzimin e personave, vjedhjet e organizuara të banesave dhe automjeteve, etj;
- Mbështetja e strukturave të hetimit të krimeve me bazën e nevojshme materiale, logjistike e mjetet bashkëkohore teknologjike;
- Konsolidimi i strukturave dhe kapaciteteve të hetimit të Policisë së Shtetit, duke u fokusuar në veprat penale të kultivimit dhe trafikimit të drogës, krimit ekonomik e financiar, krimet seksuale, veprat që kanë të bëjnë me trafikimin e personave, kontrabandimin e migrantëve, prostitucionin dhe shfrytëzimin e tij, krimin kompjuterik;
- Marrja e masave me qëllim rritjen e sigurisë së dëshmitarëve

dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, përmirësimin e metodave të mbrojtjes dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar;

- Intensifikimi i bashkëpunimit me Zyrën e Prokurorisë së Posaçme, Shërbimin Informativ Shtetëror, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, etj.;
- Ngritja dhe përdorimi i skuadrave të përbashkëta hetimore me agjencitë ligj zbatuese të vendeve të tjera me qëllim rritjen dhe lehtësimin e shkëmbimit të drejtpërdrejtë të informacionit dhe kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore policore;
- Aplikimi i një standardi të detyrueshëm sipas modelit të BE-së për kthimin e automjeteve të vjedhura të gjendura në Shqipëri dhe shkurtimin e kohës së nevojshme për kthim në vendin e origjinës;
- Ngritja e Skuadrës FAST (Kërkimit Aktiv të të Arratisurve) përmes mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë dhe kryerja e kërkimeve të përqendruara për personat në kërkim në bashkëpunim me ENFAST (Rrjeti Europian i Ekipeve Aktive të Kërkimit të të Arratisurve);
- Përqëndrimi në hetime që kanë rëndësi parësore, duke marrë në konsideratë kufizimet në burime njerëzore dhe logjistike, si dhe duke racionalizuar forcat dhe hequr dorë nga puna “për dukje dhe statistika”. Puna e çdo oficeri apo agjenti të policisë do të matet me rezultatet konkrete të arritura në terren dhe në veprimtarinë hetimore;
- Kryerja e hetimeve ndaj veprimtarive dhe strukturave të krimit të organizuar paralelisht me hetimet mbi asetet dhe produktet e veprimtarive të paligjshme;
- Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të policisë shkencore sipas standardet ndërkombëtare në këtë fushë;

- Rritja e numrit të fushatave ndërgjegjësuere për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe median;
- Rritja e nivelit të bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit dhe numrit të operacioneve të përbashkëta me shërbimet inteligjente dhe ligj zbatuese në vend dhe rajon, me qëllim ruajtjen në nivelin “I ULËT” të kërcënimit nga terrorizmi dhe marrjen e masave të nevojshme për parandalimin e akteve terroriste;
- Trjanimi i punonjësve të Drejtorisë Anti-Terror me taktikat dhe teknikat bashkëkohore. Sigurimin e aksesit në të dhënat e institucioneve të tjera, rritjen e numrit të hetimeve proaktive ndaj individëve/grupeve të dyshuar për veprimtari kriminale me sfond terrorist, monitorimin dhe kontrollin e luftëtarëve të huaj terroristë, personave me risk dhe atyre të vendosur në rubrikën “Njoftim në Kufi”;
- Parandalimi i esktrimizmit të dhunshëm do të kryhet edhe përmes policimit në komunitet, bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm vendorë, si dhe realizimit të fushatave ndërgjegjësuere.

IV. Siguri publike dhe shërbime efikase ndaj qytetarëve

Përmes forcimit dhe përsosjes së sistemit të policimit në komunitet dhe përmirësimit rrënjësor të sistemit të kontroleve dhe inspektimeve në territor, **ne synojmë të forcojmë Sigurinë Publike dhe të sigurojmë shërbime efikase ndaj qytetarëve.**

Objektivat e këtij prioriteti përfshijnë:

1. Ndëshkimi i paligjshmërisë në territor, për vepra që çënojnë sigurinë publike, të tilla si: prodhimit dhe shitjes së ushqimeve dhe lëndëve të rrezikshme për shëndetin, krimit mjedisor,

dëmtimit e zjarrvënies së pyjeve, gërryerjes së lumenjve, ndërtimeve pa leje, lidhjeve të paligjshme të ujit dhe energjisë, etj;

2. Funksionimin e një sistemi më efikas dhe transparent të shërbimeve të inspektimit dhe kontrolleve ndaj territorit dhe marrëdhënieve të tyre me bizneset;
3. Përmirësimin thelbësor të sistemit të komunikimit të të dhënave dhe bashkëpunimit ndërmjet strukturave të policimit në komunitet dhe shërbimeve të kontrollit e inspektimit, por dhe nevojës për evidentimin e saktë dhe përqendrimin më mirë në to të burimeve me natyrë inspektuese.
4. Lehtësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve.

Në funksion të përmbushjes së këtij prioriteti strategjik dhe objektivave përkatës do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor të nevojshëm për ristrukturimin, organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të inspektimit dhe kontrollit, që do të jenë nën varësinë e Ministrisë së Brendshme;
- Miratimi i akteve nënligjore lidhur me kriteret e rekrutimit, përcaktimit të funksioneve e përgjegjësi, rregullat e funksionimit dhe monitorimit si dhe ato të trajnimit;
- Hartimi i një akti ligjor të nevojshëm për lehtësimin e aksesimit nga institucionet publike të RKGJC;
- Mbështetja e bashkive për shërbimin e “zyrës me një ndalesë” - one stop shop;
- Përgatitja e një plani masash për zbatimin e ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”;
- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për masat shtesë të sigurisë”;

- Përmirësimi i kuadrit ligjor për rregullimin e veprimtarisë së SHRSF-ve dhe kontrollit mbi to.
- Riorganizimi dhe standardizimi i marrjes, ruajtjes dhe publikimit të të dhënave dhe statistikave.
- Përfundimi i projekteve të “Menaxhimit policor të çështjes”, “Për personelin”, “Matjen e performancës”, “Për sistemin e vëzhgimit në qytetin e Tiranës”;
- Implementimi i projektit mbi “Sistemin dixhital të radiokomunikimit në PSH”;
- Kompletimi i bazës së të dhënave dhe vënia në funksionim e shërbimeve në dinamikën e luftës kundër krimit;
- Krijimi i një sistemi *on-line* të përditësuar të menaxhimit të performancës për vlerësimin e kënaqësisë (*Customer Satisfaction*) për shërbimet e ofruara ndaj komunitetit dhe nivelin e krimit në zonat gjeografike;
- Vënia në funksionim e sistemit *on-line* të inspektimit në territor, me qëllim shmangien e inspektimeve abuzive ndaj qytetarit dhe biznesit.

V. Kufij të sigurtë – menaxhim i integruar i tyre

Forcimi i kontrollit në kufi dhe përmirësimi i shërbimit në pikat e kalimit kufitar, mbetet prioritet për qeverinë, si kusht për të garantuar lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave.

Objektivat e këtij prioriteti përfshijnë:

1. Menaxhimin e integruar të kufijve, sigurimin e tyre ndaj formave të ndryshme të krimit ndër-kufitar, përfshi dhe elementët me prirje radikale apo terroriste;
2. Koordinimin dhe menaxhimin më të mirë të përpjekjeve

për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, flukseve migratore dhe kërkesave të pabazuara për azil;

3. Manaxhimi i integruar i kufirit blu dhe të gjelbër dhe flukseve përmes aeroportit ndërkombëtar të Rinasit si porta kryesore e vendit;
4. Përmirësimin e performancës dhe sjelljes etike të punonjësve të shërbimit në pikat tona kufitare;
5. Menaxhimin më të mirë të vijës bregdetare në funksion të cilësisë së shërbimit turistik dhe sigurisë së jetës të qytetarëve.

Në funksion të përmbushjes së këtij prioriteti strategjik dhe objektivave përkatës do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Riorganizimi i strukturave të Policisë Kufitare dhe Migracionit, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, në bazë të nevojave të identifikuar dhe rekomandimeve të ekspertëve të Komisionit Europian;
- Ruajtja e autonomisë dhe riorganizimi i Departamentit të Kufirit dhe Migracionit (DKM) sipas modelit EU-IBM, të parashikuar nga neni 4 i Rregullores (BE) 1624/2016 për lehtësimin e flukseve ndërkufitare, fuqizimin e luftës kundër trafikeve të paligjshme, përmirësimin e analizave të riskut dhe bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Përmirësimi i procedurave të shqyrtimit paraprak të profilit të emigrantëve të paligjshëm në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare në vend;
- Modernizimi dhe përditësimi i sistemit kombëtar të regjistrimit kufitar TIMS;
- Ndarja qartësisht e detyrave e policisë kufitare nga ato të operatorit të aeroportit të Rinasit;
- Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të policisë kufitare në fushën e sigurisë aeroportuale;

- Aplikimi i një sistemi të shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit me aeroportet e vendeve të tjera;
- Përgatitja e qenve të policisë dhe pranisë së tyre në pikat kryesore të kalimit kufitar;
- Harmonizimi i kuadrit ligjor në fuqi kundër trafikimit të qenieve njerëzore në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar dhe Protokollit të Dytë shtesë të saj dhe Konventën e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”;
- Funkionimi i pikave kufitare si baza të dhënash për strukturat e tjera të policisë dhe agjencive të tjera ligj zbatuese, përmes regjistrimit, përpunimit, analizimit dhe shkëmbimit të informacionit rreth shtetasve, të cilët janë proceduar penalisht jashtë vendit;
- Përgatitja e një plani të detajuar masash për menaxhim e sezonit turistik, duke iu referuar përvojave më të mira Europiane, siç është ajo e Kroacisë;
- Kryerja e studimit për mundësinë e krijimit të sistemit automatik të kontrollit të dokumenteve biometrikë “e-Gate” në pikat e kalimit kufitar;
- Aplikimi i protokolleve të Informacionit të Përparuar të Pasagjerëve (API);
- Forcimi i regjimit të kontrollit për parandalimin azilkërkimit në vendet e BE-së përmes aplikimit të kriterëve më të rrepta, veçanërisht për të miturit (rishikimi i deklaratës noteriale; alerti në sistemin TIMS në rast të kthimit të personave të rritur pa fëmijët që shoqëronin);
- Aplikimi i një sistemi “trajno trajnuesit” me zyrtarët e policisë kufitare që kanë kualifikimin përkatës, ofrimi i kurseve efektive të gjuhës së huaj dhe kurseve trajnuese përmes kompjuterit;
- Rinovimi i pikave të kalimit kufitar, zbatimi i planit për ngritjen e

një Qendre Bashkëpunimi Policor në Veri të Shqipërisë, bashkë me Malin e Zi dhe Kosovën;

- Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimi i infrastrukturës teknike të Qendrës Ndërinstitucionale të Operacioneve Detare në Durrës dhe funksionimit të sistemit të radarëve të policisë kufitare;
- Bashkëpunim i ngushtë me degët doganore në të gjitha pikat e kalimit kufitar në drejtim të parandalimit dhe rritjes së zbulueshmërisë së trafikeve të paligjshme;
- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional me Ministrinë e Mbrojtjes dhe agjencitë e tjera, në funksion të forcimit të kapaciteteve të kontrollit të kufirit blu për parandalimin e trafikimit të narkotikëve.
- Hartimi i një plani masash për trajnimin special detar të policisë kufitare në Detin Adriatik / Detin Jon dhe në liqenet e Ohrit dhe Shkodrës;
- Ngritja e Qendrës së Bashkëpunimit Policor me Greqinë;
- Sigurimi i përkthyesve në pikat e kontrollit kufitar përgjatë kufirit me Greqinë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare për menaxhimin e flukseve të migrantëve;
- Përmirësimi, në bashkëpunim me Kapitenerinë e porteve, i regjistrimit detar të mjeteve të lundrimit dhe të sigurohet akses i plote në këtë regjistër për PKM.

VI. Lufta kundër kultivimit dhe trafikimit të drogës

Shqetësimet serioze të shkaktuara nga kultivimi, trafikimi dhe konsumi i drogave, na bëjnë ne të vendosur për të vazhduar më tej betejën pa kompromis kundër këtij fenomeni të paligjshëm dhe kriminal. Ne rikonfirmojmë zotimin e qeverisë shqiptare për të kthyer në një realitet të konsoliduar atë çfarë arritëm gjatë vitit 2017 - heqjen e vendit tonë nga harta e vendeve kultivuese të kanabisit.

Objektivat e këtij prioriteti përfshijnë:

1. Hartimin e Planit të Masave për vitin 2018, në zbatim të Planit të Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit.
2. Konsolidimin e përvojës së fituar gjatë vitit 2017, për një kontroll sa më të mirë të territorit me synimin për të mos pasur më kultivim të kanabisit në zonat e mëparshme të njohura për prodhimin e tij dhe minimizimin në mënyrë të ndjeshme edhe në zonat e vështira malore;
3. Uljen në mënyrë të ndjeshme të rasteve të trafikimit të drogave të ndryshme nga/dhe përmes territorit shqiptar, veçanërisht përmes pikave të kalimit kufitar;
4. Arritjen e rezultateve konkrete në luftën kundër strukturave kriminale që operojnë në fushën e trafikimit të drogës me zbulimin dhe arrestimin e drejtuesve dhe anëtarëve të tyre, e shoqëruar kjo veçanërisht me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të krijuara nga ky aktivitet i paligjshëm;
5. Reduktimin maksimal të pranisë dhe aksesit ndaj drogave pranë institucioneve arsimore.

Në funksion të përmbushjes së këtij prioriteti strategjik dhe objektivave përkatëse do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Kryerja e një analize të plotë mbi përvojën e krijuar gjatë këtij viti në fushën e luftës kundër kultivimit të kanabisit në zbatim të Planit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit, duke përmirësuar më tej elementët e tij kryesorë të kontrollit eficient të territorit, bashkëveprimin me agjencitë e tjera ekzekutive dhe organet e qeverisjes vendore, përsosjen e sistemit elektronik të kontrollit të territorit dhe përmbushjen me efikasitet të përgjegjësive përkatëse;
- Ngritja e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin dhe përmirësimin e Planit Kombëtar kundër Kultivimit dhe

trafikimit të kanabisit;

- Bashkëhartimin e një plan veprimi me partnerët ndërkombëtar e veçanërisht me ata Italianë (GDF e Interforze) si dhe me misionin PAMECA, duke ngritur një mekanizëm të përbashkët monitorimi, për kontrollin e territorit nga toka dhe ajri në zonat e vështira malore, sipërfaqen ujore dhe pikat e kalimit kufitar, si dhe për shkëmbimin e informacionit me agjencitë partnere në rajon;
- Rritja e numrit të personelit të specializuar për hetimin e veprave penale në fushën e narkotikëve;
- Mbështetja me teknologji të posaçme bashkëkohore, shkëmbimi më eficient i informacionit me agjencitë e tjera ligj zbatuese dhe shërbimet partnere ndërkombëtare si dhe rritje e mbështetjes për rrjetin e informatorëve;
- Hartimi i një plani veprimi të posaçëm, në bashkëpunim me agjencitë e tjera ligj zbatuese, organet e pushtetit vendor, institucionet arsimore si dhe vetë komunitetin e prindërve për të goditur fort rastet e pranisë dhe aksesit ndaj drogave pranë institucioneve arsimore dhe në të gjitha mjediset e frekuentuara nga nxënës dhe studentë, si dhe duke bashkëpunuar në drejtim të parandalimit të përhapjes së këtij fenomeni në radhët e tyre;
- Sigurimi i ambienteve të përshtatshme dhe të sigurta për administrimin, ruajtjen dhe trajtimin e provave materiale të drogave, mbështetur në rekomandimet e Komisionit Europian dhe misionit TAIEX;

VII. Lufta kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave

Angazhohemi për një luftë pa kompromis dhe pa dallim ndaj korrupsionit dhe pastrimit të parave në bashkëpunim me Prokurorinë, strukturat e Hetimit Tatimor dhe Doganor, Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Objektivat e këtij prioriteti përfshijnë:

1. Arritjen e rezultateve konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave, duke synuar kryerjen e hetimeve proaktive, referime shumë më profesionale bazuar në të dhëna konkrete dhe të verifikueshme dhe ndjekje deri në fund të procesit të trajtimit të tyre nga prokuroria e gjykatat;
2. Rritjen e rasteve të referimeve për të ardhurat dhe pasuritë e pajustificuara që rrjedhin nga korrupsioni në zbatim edhe të ndryshimeve të reja ligjore në këtë fushë;

Në funksion të përmbushjes së këtij prioriteti strategjik dhe objektivave përkatës do të ndërmerren masat e mëposhtme :

- Riorganizimi në qendër dhe në rajone i strukturave të hetimit të krimit ekonomik, korrupsionit dhe pastrimit të parave;
- Rritja e kapaciteteve njerëzore me punonjës të specializuar dhe me integritet të lartë njerëzor, të mirë trajnuar, të cilët në veprimtarinë e tyre, do të mbështeten me infrastrukturën e nevojshme logjistike për realizimin e hetimeve proaktive dhe përdorimin e teknikave speciale të hetimit;
- Mbështetja me teknologji të posaçme bashkëkohore, shkëmbimin më eficient të informacionit me agjencitë e tjera ligj zbatuese dhe shërbimet partnere ndërkombëtare si dhe rritjen e mbështetjes për rrjetin e informatorëve;
- Sigurimi i aksesit të strukturave të hetimit të krimit ekonomik, korrupsionit dhe pastrimit të parave në databazat e institucioneve të tjera publike si dhe ofrimi i mbështetjes së nevojshme logjistike dhe teknike për ndjekjen e hetimeve;
- Intensifikimi i bashkëpunimit ndërinstytucional ndërmjet këtyre strukturave me prokurorinë dhe agjencitë e tjera ligj zbatuese, si ato të BKH, SPAK, Hetimit Tatimor dhe Doganor, Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave, etj;

- Paraqitja për herë të parë e raportit kombëtar të situatës së korrupsionit duke përfshirë numrin e procedimeve penale, fushat ku përqendrohet korrupsioni dhe dënimet.

VIII. Siguria rrugore

Ne do të angazhohemi për përmirësimin rrënjësor të sistemit të kontrollit rrugor, duke synuar krijimin e një kulture të re në qarkullimin e mjeteve dhe të qytetarëve dhe sidomos në menaxhimin e sigurisë rrugore. Do të implementohen sisteme të avancuara teknologjike të mbikëqyrjes së qarkullimit rrugor dhe të evidentimit të saktë dhe në kohë reale të shkeljeve të dispozitave të kodit rrugor, si dhe një sistem i automatizuar dhe i perfeksionuar për vendosjen dhe mbledhjen e gjobave.

Objektivat e këtij prioriteti përfshijnë:

1. Parandalimin dhe reduktimin e ndjeshëm të aksidenteve sidomos të atyre me pasojë humbjen e jetës;
2. Krijimin e një kulture të re të qarkullimit rrugor nga qytetarët;
3. Sigurimin e një menaxhimi më të mirë të qarkullimit rrugor dhe sigurisë rrugore sidomos në akset kombëtare;

Në funksion të përmbushjes së këtij prioriteti strategjik dhe objektivave përkatës do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Hartimi i një masterplani për mundësitë e ndryshimit rrënjësor të sistemit aktual të menaxhimit të sigurisë rrugore në bashkëpunim me ekspertizën ndërkombëtare në këtë drejtim;
- Implementimi i sistemeve të avancuara teknologjike të mbikëqyrjes së qarkullimit rrugor dhe të evidentimit të saktë dhe të menjëhershëm të shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor;
- Rritja e investimeve në teknologji për Policinë Rrugore, ulja

graduale e numrit të punonjësve të saj të pranishëm në akset rrugore dhe zëvendësimi i tyre nga pajisjet teknologjike;

- Vlerësimi i kapaciteteve të policisë rrugore, aftësive të tyre profesionale, si dhe pajisja e tyre me mjete të motorizuara dhe teknologjike, me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimit;
- Përmirësimi i sistemit të gjobave për shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, përmes futjes së tabletave elektronike, si dhe ndryshimeve në sistemin e ankimit ndaj gjobave për të eliminuar çdo lloj mundësie vlerësimi subjektiv dhe eliminimin e burokracive në ofrimin e shërbimit ndaj qytetarëve;
- Riorganizimi i Policisë Rrugore në të gjithë territorin e vendit sipas modelit të Komisarariatit të Policisë Rrugore të Tiranës, si pjesë e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë;
- Hartimi i një plani të detajuar bashkëveprimi me institucionet arsimore, median dhe shoqërinë civile për sensibilizimin qytetar, sidomos të fëmijëve e të rinjve lidhur me respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor dhe pasojat përkatëse në rast të shkeljes së tyre;
- Hartimi i një plani në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës lidhur me rritjen e parametrave të sigurisë rrugore dhe masat për kontrollin e tyre, për menaxhimin më mirë të akseve rrugore dhe shërbimeve ndaj kompanive me risk të shtuar;
- Hartimi i një marrëveshje të re bashkëpunimi me shoqëritë e sigurimeve dhe entin rregullator mbikëqyrës të tyre lidhur me përmbushjen e detyrimeve respektive në fushën e sigurisë rrugore;
- Kontroll periodik i zbatimit të dispozitave për regjistrimin e automjeteve, sidomos atyre që parashikojnë heqjen nga qarkullimi rrugor i të gjitha automjeteve me targa të pavlefshme.

IX. Inteligjenca dhe informacioni

Fuqizimi i kapaciteteve të shërbimeve të inteligjencës dhe informacionit përbën një domosdoshmëri përballë sfidave ndaj rendit dhe sigurisë publike dhe sidomos veprimtarive të organizuara kriminale, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Udhëheqja nga Inteligjenca e veprimtarisë së strukturave të policisë gjyqësore në tërësi dhe asaj kriminale në veçanti, përbën një model modern policimi të karakterizuar nga një qasje pro-aktive hetimore dhe rezultate efikase. Aplikimi me sukses i shërbimeve të inteligjencës dhe informacionit është kusht për përmbushjen e shumë prej prioriteteve të paraqitura në këtë dokument.

Objektivat e këtij prioriteti përfshijnë:

1. Krijimin e një sistemi bashkëkohor të inteligjencës dhe informacionit në luftë kundër kriminalitetit dhe veçanërisht kriminit të organizuar;
2. Realizimin e hetimeve proaktive dhe marrjen e vendimeve nga strukturat e policisë mbështetur mbi rezultatet e produkteve të inteligjencës dhe analizës;
3. Fuqizimin e kapaciteteve profesionale, teknike dhe logjistike të strukturave inteligjente të Policisë;
4. Forcimin e bashkëpunimit në analizimin dhe shpërndarjen e informacionit.

Në funksion të përmbushjes së këtij prioriteti strategjik dhe objektivave përkatës do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Përmirësimi i procedurave dhe praktikës së mbledhjes, përpunimit, analizimit dhe shpërndarjes së informacionit/inteligjencës;
- Hartimi në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë i Strategjisë Kombëtare të Inteligjencës dhe Informacionit;

- Ngritja e strukturës përgjegjëse për drejtimin dhe harmonizimin e shërbimit të Inteligjencës dhe Informacionit;
- Ngritja e një Sistemi Kombëtar të Unifikuar të Inteligjencës, i cili do të përmbajë çdo të dhënë, të çdo lloji, për persona të cilët në një mënyrë ose në një tjetër kanë qenë objekt i punës së agjencive të zbatimit të ligjit;
- Ngritja e Shërbimit të Unifikuar të Komunikimit, Shërbimit të Menaxhimit të Fluksit të Dokumenteve të Punës, dhe Shërbimit të Teknologjisë së Komunikimit dhe Informacionit;
- Rishikimi i akteve normative lidhur me Rrjetin Sekret Informativ (RSI) dhe përmirësimi cilësor i sistemit të rekrutimit, ruajtjes, vlerësimit dhe shpërblimeve ndaj tyre;
- Krijimi i hartave të krimit “crime mapping” dhe profileve të grupeve të krimit të organizuar në çdo drejtori vendore të policisë;
- Zgjerimi i aksesit në sistemin MEMEX tek më shumë përdorues në Drejtorinë Vendore të Policisë dhe hedhja në sistem e informacioneve që lidhen me një aktivitet kriminal pas verifikimit të tyre;
- Sigurimi i mbështetjes financiare dhe logjistike për Institutin e Policisë Shkencore, përfshirë dhe ndryshimet ligjore për krijimin e “fondit të vetë-zhvillimit”. Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të policisë shkencore sipas standardeve ndërkombëtare në këtë fushë;
- Sigurimi i aksesit të plotë të Policisë Kriminale në databazat publike kombëtare, kompanitë celulare dhe në të dhënat e klientëve të internetit konform legjislacionit përkatës dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;

X. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar

Prioretet e mësipërme kërkojnë si domosdoshmëri konsolidimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me organizatat e specializuara në luftën kundër krimit përfshi dhe asistencën direkte në territorin tonë nga institucionet ndërkombëtare dhe/ose nga shërbimet policore partnere në luftë kundër krimit, kryesisht atij të organizuar.

Objektivat e këtij prioriteti përfshijnë:

1. Forcimin e bashkëpunimit institucional dhe bashkëveprimit operacional me agjencitë ndërkombëtare në fushën e luftës kundër krimit;
2. Fuqizimin e bashkëpunimit me vendet partnere, rritjen e asistencës së tyre dhe numrit të operacioneve të përbashkëta kundër grupeve/ organizatave kriminale që veprojnë në territore të përbashkëta;

Në funksion të përmbushjes së këtij prioriteti strategjik dhe objektivave përkatës do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe dhe rajonale për luftën kundër kriminalitetit duke ndërtuar një sistem periodik analize dhe kontrolli për zbatimin e tyre;
- Institucionalizimi i ngritjes së skuadrave policore mobile të përbashkëta me vendet partnere si mundësi për shkëmbimin e shpejtë të informacionit, kryerjen e operacioneve të përbashkëta të hetimit penal, mbrojtjen më mirë të të dhënave dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, përdorimin e metodave dhe teknologjisë bashkëkohore, por edhe si një mundësi e mirë për aftësimin e mëtëjshëm profesional të strukturave tona policore;
- Krijimi i Forumit “Miqtë e Ministrisë së Brendshme” i përbërë nga përfaqësitë diplomatike dhe misionet e asistencës në fushën e rendit dhe sigurisë publike, me qëllim bashkërendimin e asistencës

së ofruar për realizimin e prioriteteve, si dhe koordinimin e mbështetjes së tyre financiare e logjistike për strukturat e Ministrisë dhe Policisë së Shtetit;

- Ngjitjen e strukturave negociuese, në kuadër të procesit të pre-screening për Kapitullin 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria” dhe hartimin e Planit të Veprimit përkatës;
- Ngritja e njësisë për hartimin, koordinimin dhe monitorimin e projekteve me financim të huaj në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Integritit dhe ndërtimi i një databaze për të gjitha projektet e realizuara dhe ato të planifikuara me qëllim shmangjen e mbivenmdosjeve dhe ruajtjen e koherencës së interesave kombëtare;
- Rritja e numrit të aksioneve të përbashkëta ndërkombëtare policore (ekipet e përbashkëta hetimore, operacionet e përbashkëta, dorëzimet e kontrolluara, etj) në të cilat ka marrë pjesë apo janë inicuar nga Shqipëria;
- Fillimi i procedimeve penale në Shqipëri kundër shqiptarëve të dyshuar për krime të kryera në vende të tjera, kryesisht ato në fushën e trafikimit të narkotikëve dhe krimit të organizuar.

ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Zbatimi në praktikë i vullnetit politik të qeverisë shqiptare të shprehur në këto dhjetë prioritete, do të kryhet përmes përmbushjes së objektivave dhe masave konkrete të parashikuara për çdo prioritet. Plani i Veprimit, i cili shoqëron dhe plotëson këtë dokument, përmban veprimtaritë konkrete që duhen ndërmarrë, treguesit e matshëm, afatet përkatëse dhe mbështetjen financiare për realizimin në praktikë të tyre.

Zbatimi i plotë i Dokumentit mbi Politikën në fushën e rendit dhe

sigurisë të Ministrisë së Brendshme, është planifikuar të realizohet në një periudhë kohore katër vjeçare.

Monitorimi i zbatimit të Prioriteteve, Objektivave dhe Planit të Veprimit do të kryhen në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke përfshirë mundësinë e inspektimeve periodike gjatë gjithë periudhës katër vjeçare. Analiza e progresit të bërë dhe problematikave të shfaqura gjatë zbatimit të dokumenteve strategjike do të kryhet në baza gjashtë mujore.

REFERENCAT

Për hartimin e këtij dokumenti i cili përbën prioritetet, objektivat dhe masat konkrete për tu zbatuar gjatë periudhës 2017-2021, janë marrë në konsideratë analiza të ndryshme të realizimit të strategjive ekzistuese sektoriale dhe ndër-sektoriale. Konkretisht, dokumentet strategjike kryesorë të konsultuara për efekt të hartimit të këtij dokumenti, përfshijnë:

- Strategjia ndërsektoriale për luftimin e krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm dhe terrorizmit 2013 - 2020
- Strategjia e integruar e menaxhimit të kufijve 2014-2020
- Strategjia kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe plani i veprimit 2014 - 2017
- Strategjia e rendit publik dhe plani i veprimit 2015-2020
- Plan i Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017-2020

Gjithashtu, janë marrë në konsideratë strategji të tjera dhe plane veprimi që lidhen me veprimtarinë e MB-së, siç janë :

- Strategjia e Qeverisë Shqiptare kundër korrupsionit dhe plani i veprimit (2105-2020)
- Plan kombëtar për Integrimin Evropian 2017-2020

Ky dokument është në përputhje dhe plotësim të strategjive të sipër përmendura. Ai është konsultuar intensivisht me ekspertë të së drejtës penale, prokurorë, avokatë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që operojnë në këtë fushë dhe gazetarë investigativë të medias në vend. Ky dokument reflekton po ashtu, kontributet me vlerë të partnerëve ndërkombëtarë (ICITAP, PAMECA V, Prezenca e OSBE), si dhe përfaqësuesve të vendeve anëtare të BE-së. Prioritetet e shpalosura në këtë dokument janë produkt i një procesi gjithëpërfshirës konsultimi në përgjigje të dinamikave të kriminalitetit dhe sfidave më të fundit që i paraqiten shtetit të së drejtës dhe rendit publik. Këto dinamika dhe sfida janë të karakterit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Për këtë qëllim, përfaqësues të misionëve ndërkombëtare dhe vendeve partnere janë gjithashtu të ftuar të asistojnë me praktikat më të mira me qëllim jetësimin e këtyre prioritetëve.